



Datë: 12.09.2025
Numër Protokolli: 6121/2025

A.nr.1470/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani dhe, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1470/2025, të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesja A.Z-A kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1470/2025, e datë 25.07.2025, e parashtruar nga ankuesja A.Z-A.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil A.Z-A (*tutje referuar ankuesja*), më datë 25.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 02-016-41592/25, të datës 22.05.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankueses për pozitën Zyrtar për Shërbime me Qytetar dhe Vendimit me numër protokolli 02-16/01-41559/25, të datës 22.05.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankueses për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile 2, të lëshuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjilanit, ndërsa e njëjta më datë 12.09.2025, ka bërë tërheqjen e ankesës.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1470/2025 të datës 25.07.2025.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1470/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.Z-A;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së